



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 381 Prot.

Tiranë, më 20.02 2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 16 dt. 20.02 2026

“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E
ZGJEDHJEVE TË AUTORITETEVE DHE ORGANEVE DREJTUESE NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 4, gërma a, nenin 33 paragrafi 3, nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 7 paragrafi 4 gërma a dhe 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST, shkresën nr.3013/2 prot., datë 28.01.2026 të KIZ “Për përcjelljen e relacionit sqarues për ndryshime në Rregulloren për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Senati Akademik

VENDOSI:

I. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Zgjedhjet e Autoriteteve dhe Organeve Drejtuese në Universitetin e Sporteve të Tiranës si më poshtë:

1. Në pikën 4 të nenit 6 të Rregullores të hiqet fjala “e vuloset”;

Ishte: Sekretari i KIZ përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZ. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kerkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset **e vuloset** nga sekretari. Sekretari i KIZ është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZ.

Behet: Sekretari i KIZ përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZ. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kerkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset nga sekretari. Sekretari i KIZ është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZ.

2. Pas nenit 7 të Rregullores të shtohet neni 7/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 7/1

Komisioni Zgjedhor Ad-Hoc

1. Komisioni Zgjedhor Ad-Hoc ngrihet me Vendim të KIZ për procedurat zgjedhore që thirren jashtë rradhe dhe kanë përfshirjen në votim të dy apo më shumë njësisive kryesore.
 2. Komisioni Zgjedhor Ad-Hoc ka në përbërje 5 anëtar, ku përfaqësohet me anëtar nga çdo njësi kryesore dhe ku njëri prej anëtarëve është student. Kur nuk është e mundur përfaqësimi me anëtar nga çdo njësi kryesore, atëher anëtarët zgjidhen sipas kandidatëve që kanë vetë aplikuar.
 3. Funksionet e Komisionit Zgjedhor Ad-Hoc janë të njëjta me funksionet që Komisionet e Zgjedhjeve kanë për procesin zgjedhor për të cilin janë ngritur.
 4. Funksionet e Komisionit Zgjedhor Ad-Hoc mbarojnë me përfundimin e procedurës zgjedhore dhe shpalljen e fituesit.”
3. Pas pikës 3 të nenit 28 të Rregullores, të shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje: “Kur fletët e votimit për autoritete apo organe drejtuese është më pak se 100, shtohen jo më pak se 5 fletë votimi”

II. Ky Vendim i përcillet Komisionit Institucional Zgjedhor të UST.

III. Ky Vendim i përcillet njësisive kryesore të UST dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko Shkencore për publikim.

IV. Ky Vendim depozitohet në Ministrinë e Arsimit.

V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

